

VENDIM
Nr. 937, datë 18.11.2015

PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA DREJTORIA E POLICISË SË SHTETIT TE MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME, PËR PREFEKTIN E QARKUT TË TIRANËS DHE ADMINISTRATËN E TIJ, TË PRONËS ME EMËRTIMIN “KOMISARIATI I POLICISË NR. 2 TIRANË (MENSË - KUZHINË)” DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 250, DATË 24.4.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, TË NDRYSHUAR, E PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 1691, DATË 10.10.2007, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Drejtoria e Policisë së Shtetit te Ministria e Punëve të Brendshme, për prefektin e Qarkut të Tiranës dhe administratën e tij, të pronës me emërtimin “Komisariati i Policisë nr. 2 Tiranë (mensë-kuzhinë)”, sipas formularit dhe genplanit, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij, për t’u përdorur nga sektori i PMNZH-së i Qarkut të Tiranës.

2. Prona e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 250, datë 24.4.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Rendit Publik”, të ndryshuar, dhe të shtohet në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 1691, datë 10.10.2007, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Brendshme, për prefektët në qarqe dhe administratën e prefektëve, nënprefektët dhe administratën e nënprefektëve dhe për Drejtorinë e Përgjithshme të Emergjencave Civile (Drejtorisë së PMNZSH-së)”, të ndryshuar.

3. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Drejtoria e Policisë së Shtetit, prefekti i Qarkut të Tiranës e kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

3.FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(Të tipit të pronave që inventarizohen si klasa të veçanta)

A		B					C			
Nr. Rend	Zona Kadastrale Indeksi Hartes	Nr. Pasurise	Emertesa e pronës Vend ndodhja / Shtetirja Gjeografike	Komponentet Perberes te Pronës	Adresa/vend ndodhja e komponenteve perberes	Permasat e pronës ne m2 ose m	Funksioni por te cilin përdoret Prona	Institucioni / Enti me përgjegjësi administrative	Institucioni/Enti përdorues Statusi juridik i përdorimit	Te dhëna te tjera (Shënimë te veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
17			Komisariati Policise Nr.2-Tirane (Mence-Kuzhine)		Truali Total	345.3				Sipas VKM nr.250, dt.24.04.2003 përshihet prona Mence Kuzhine Komisar. Policie nr.2 ne formularin nr."1" te inventarit te pronave te paluajtshme me numer rendor "2".
18				Mence Kuzhine		115		Ministria e Brendshme	Drejtoria Policise Qarkut Tirane	me sipërfaqe totale prone 302 m².
19				Depo ushqimi		20.3		Ministria e Brendshme	Drejtoria Policise Qarkut Tirane	me sipërfaqe totale te dy ndertesave (mence-kuzhine + depo), 126 m².
20				Mur rrethues		120.6				Nga matjet faktike nga inxhinieri i licensuar dhe nga rezultatet ne ZRPP: sipërfaqet reale jane : sipërfaqe totale prone 345.3 m² dhe sipërfaqe ndertese 135.3 m² Mence-Kuzhine 115 m² Depo ushqimi 20.3 m² Mur rrethues 120.6 m²

GENPLANI I OBJEKTIT DREJTORIA E POLICISE SE QARKUT TIRANE KUZHINA E KOMISARIATIT NR.2 NE RRUGEN ARTAN LENJA

MENCE-KUZHINE
DEPO USHQIMI
MUR RRETHUES

PLAN RILEVIMI

ATITI:

Artan Disha
Nr.T 0224/1 Date 28/02/2003
Regjistruar:30/11/2008

IDENTIFIKIMI I PASURISE:

ZONA KADASTRALE 8220
NR.PASURISE 3/19 VOL. FQ
INDEKSI I HARTES TR: O-8, P-8
SHKALLA 1:500
ADRESA E PASURISE: Rrethi TIRANE
Q/F TIRANE Rr/I
P/G SH K Ap

PRONARI: DREJTORIA E POLICISE E QARKUT TIRANE

SIPËRFAQJA NËN OBJEKT=135.3 m²

SIPËRFAQJA FUNKSIONALE=210 m²

SIPËRFAQJA TOTALE=345.3 m²

SIPËRFAQE KUZHINE=115m²

USHQIMI=20.3m²

